



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 352 Prot.

Tiranë, më datë 29.04.2022

VENDIM
Nr. 117, datë 29.04.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 29.04.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit të ri kërkimor – shkencor “Projekti shqiptaro-francez i pellgut të Korçës”, me hartues znj. Rovena Kurti dhe zhvillues Akademia e Studimeve Albanologjike;
1. Të depozitohet pranë IKTK një kopje e dokumentacionit të terrenit dhe lista e gjetjeve arkeologjike;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

